

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese - Izlazne. Date / Dana: 01.02.2024
Nr. Orgv. Org. jed. 01 Nr. Prot. Br. Prot. 05 Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KUVENDI I KOMUNËS

01.Nr. 05
Data: 31.01. 2024

Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 36.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës me datën 31.01.2024 mori:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBLEDHJEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2024.

I

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2024 do të mbahen sipas këtij orari :

1.	31	Janar	2024	e Mërkure;
2.	29	Shkurt	2024	e Enjte;
3.	28	Mars	2024	e Enjte;
4.	30	Prill	2024	e Marte;
5.	31	Maj	2024	e Premte;
6.	28	Qershor	2024	e Premte;
7.	31	Korrik	2024	e Mërkurë;
8.	30	Gusht	2024	e Premte;
9.	30	Shtator	2024	e Hanë;
10.	31	Tetor	2024	e Enjte;
11.	29	Nëntor	2024	e Premte,
12.	30	Dhjetor	2024	e Hanë.

II

Përveç mbledhjeve të rregullta të parapara në pikën (I) të këtij vendimi, Kuvendi i Komunës në Ferizaj do të mbajë edhe këto 4 mbledhje solemne dhe atë:

1. 17 Shkurt - 2024 - Dita e Pavarësisë,
2. 12 Qershor - 2024 - Dita e Çlirimit dhe
3. 28 Shtator - 2024 - Dita Komunale e Dëshmorëve,

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Lidhje: Izlazne: Date / Dana: 01.02.2024
Nr. Urgj. Br. Prot. 01 Nr. Prot. 06 Nr. Faqeve. 2
Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 06
Data: 31.01. 2024

Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, pika d të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), nenit 21 dhe 21.1 të Rregullores së Komunës së Ferizajt 01.Nr.66/12 të datës 10.09.2012 për ndarje të Subvencioneve, nenit 10 dhe nenit 25 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës: 28.6.2013, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me datën **31.01.2024** miratoi:

V E N D I M

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË LËMIN E BUJQËSISË PËR VITIN 2024

I

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për ndarjen e subvencioneve në lëmin e bujqësisë në Komunën e Ferizajt.

II

Subvencionet e përmendura në pikën një të këtij vendimi do të ndahen si në tabelën më poshtë:

	Shpërndarja e buxhetit	Vlera sipas Buxhetit/ €	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
	SUBVENCIONET		
1	Subvencionimi i fermerëve me pajisje për bletë	40,000.00	12.02.2024
2	Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor	150,000.00	15.03.2024
3	Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje	100,000.00	05.03.2024
4	Ndërtimi i dhomave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	60,000.00	05.04.2024
5	Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	50,000.00	Pa procedurë të prokurimit (pranimi i kërkesave bëhet gjatë gjithë vitit)

Gjithsej vlera e subvencioneve: **400,000.00**

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

IV

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në veb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishite/ Izlaze: Date / Dana 01.02.2024		
Nr. Urgj. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 07	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 07
Data: 31.01.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 pika 12.1 dhe 12.2 shkronja “d”, nenit 58 shkronja “h” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 7 pika 1.2 të UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 25 paragrafi 2, pika 2.1 neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES 01.NR.23 I DATËS 28.20.2020

I

Vëhet në konsultim publik Plotësim Ndryshimi i Rregullores 01.Nr.23 i datës 28.20.2020, ndryshimi do të bëhet vetëm sa i përket orarit të punës të komitetit biznesor të farmacistëve.

II

Diskutimi publik sipas nenit 1 zgjatë 30 ditë

III

Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e konsultimit publik.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorja e Shëndetësisë ajo e Zhvillimit Ekonomik dhe Zyra Komunale për Informim.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Dalese / Izlaze: Date / Dana: 01.02.2024.

Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 08 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 08
Data: 31.01. 2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E RREGULLORËS SË BRENDSHME PËR MENAXHIMIN E
PASURISË JOFINANCIARE**

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt i datës 22.01.2024 me Nr. 23/24 për aprovimin e rregullorës së brendshme për menaxhimin e pasurisë jofinanciare

II

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi dhe zbatimi i kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore përmes së cilës mundësohet evidentimi, regjistrimi dhe zotërimi i listës së pasurisë jo financiare të organizatës buxhetore.

III


Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Rregullorja e Brendshme për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare.

IV

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Financave si dhe Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 01.02.2024		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot Br. Prot. 09	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 09
Data: 31.01. 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës 7 Mars 2019, dhe nenin 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizajt 01.nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË
NGASTRËS KADASTRALE: 3621-14 Z.K.JEZERC, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM
TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 3485-4 Z.K.JEZERC,
PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.**

I

Shpallet interes i përgjithshëm-publik pjesa e ngastrës kadastrale **3621-14 Z.K.Jezerc**, me sipërfaqe 518m², pronë private e Hajrush (Milaim) Beqiri.

II

Parcela e lartëcekur në nenin i të këtij vendimi shpallet interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës **3485-4 Z.K.Jezerc**, pronë e Komunës së Ferizajt.

III

Pronat e përshkruara më lartë këmben për interes të përgjithshëm publik, me rastin e asfaltimit të rrugës "Selman Uka" në fshatin Jezerc parcela kadastrale i është marrë nga Komuna e Ferizajt, andaj personi Fizik ka kërkuar nga Komuna që të bëhet rregullimi i parcelave respektivisht këmbimi i tyre, pavarësisht se mund të ketë dallime në sipërfaqe, personi fizik nuk kërkon kompensim shtesë, në këto prona nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

IV

Këto prona këmbehen pas vlerësimit nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë dhe këmbimi i paluejtshmërive do të bëhet në proporcion me vlerat e tyre, në përputhje me vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë. Pra ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njehti shërben vetëm për vlerësimin e palujtshmërive.

V

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastrit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishese / Izlaze Date / Dana: 01.02.2024		
Nr. Orgv / Org. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 10	Nr. Faqeve / Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 10
Data: 31.01.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 mori këtë:

VENDIM

PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.113 TË DATËS 30.11.2023

I

Me këtë vendim plotësohet vendimi me Nr: 01.Nr.113 i datës 30.11.2023 në Preambulë shtohet pjesa: neni 24 i Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, Neni 29 pika 1, Rregullorës (qrk) Nr. 09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit të lartë çekur mbesin në fuqi.

III

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtorja për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
EJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Izlasme. Date / Dana: 01.02.2024		
Ur. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 11	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 11
Data: 31.01. 2024

Në mbështetje të nenit 12, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), nenit 6 pika 1, neni 8 pika 1, të nenit 14 pika 1, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 5 pika 1.2, 6 pika 3, të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të nenit 51 Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALIT AFARIST ME NUMËR KADASTRAL 0-72217092-155-2-4-0.

I

Kuvendi i Komunës miraton vendimin për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik/juridik, prona e propozuar për dhënie në shfrytëzim është lokali afarist me numër: 0-72217092-155-2-4-0, me sipërfaqe 59m² bruto, me adresë në rrugën "Dëshmorët e Kombit" Ferizaj afër postës.

II

Çmimi fillestar për 1m² është 5.00€ (pesë euro), çmimi është mujor, fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë, dhe në rast se tërhiqet ofertuesi i parë ankandi do të anulohet, dhe të rishpallet rishtazi.

III

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të cekur në nenin II të këtij vendimi është rritja e të hyrave për Komunën e Ferizajt.

IV

Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës është afatshkurtër, në periudhën deri 15 vjet.

V

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër bëhet përmes konkurrencës (ankandit) të hapur publik, të gjithë ata që aplikojnë për këtë ankand publik duhet të posedojnë garancion bankarë në vlerën prej 3.000 € (tre mijë euro)

VI

Për këtë vendim kujdesen Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër si dhe Kryetari i Komunës Ferizajt.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi